



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 24, Datë 19.02.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË  
“COSMOGRAL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 606/1 prot., datë 15.02.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Cosmogral” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 606 prot., datë 08.02.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Cosmogral” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gërmën “b”; si dhe për pikën 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### *Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “a”**: Të saktësohet objekti i aktivitetit në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në mënyrë që të ketë të përfshirë dhe veprimtarinë e furnizimit për të cilën kërkohet të licencohet nga ERE..

#### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”**: Të depozitohet në ERE vërtetimin që nuk ka asnjë detyrim në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “c”**: Të saktësohet/sqarohet përcaktimi në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe mënyrën e planifikuar për financimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**